

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 100/4 Prot.

Tiranë, më 30.12.2013



MIRATOHET

MINISTRI

LINDITA NIKOLLA

PROGRAMET E ARSIMIT BAZË

(Për fëmijët e ngjuar)

LËNDA:GJUHA SHQIPE

KLASA I-V

Tiranë

Dhjetor 2013

I. TË PËRGJITHSHME

Gjuha është mjete dhe rruga më të cilën njohim botën. Ajo mbart brenda saj shpirtin, kulturën, vlerat, historinë dhe filozofinë e popullit tonë. Duke qenë kaq e rëndësishme në jetën njerëzore, edhe mësimi i saj është një nga detyrat parësore të shkollës.

Zhvillimi gjuhësor është themelor për rritjen intelektuale, shoqërore dhe emocionale të nxënësve dhe duhet konsideruar edhe si elementi kryesor i gjithë kurrikulës së arsimit bazë. Kur nxënësit mësojnë të përdorin gjuhën gjatë viteve të para të shkollës, ata kanë marrë aftësitë e para e të domosdoshme për të vazhduar me tej.

Lënda e gjuhës shqipe për fëmijët e ngujuar zhvillohet nga klasa e parë, me abetaren, deri në klasën e nëntë. Programi i gjuhës shqipe është ndërtuar mbi bazën e parimit të integritetit, e parimit të rimarrjes së njohurive, si dhe mbi bazën e parimit linear.

II. SYNIME TË LËNDËS

Mësimi i gjuhës shqipe në arsimin bazë synon që nxënësit:

- të jenë folës dhe dëgjues aktivë dhe korrektë në situata të ndryshme komunikimi;
- të lexojnë rrjedhshëm tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, të përshtatshme për moshën dhe qëllimin që kanë;
- të gjejnë, krahasojnë, analizojnë e vlerësojnë informacione nga tekste të ndryshme, t'i përshtatin ato me qëllime dhe audiencë të caktuara, si dhe t'i integrojnë ato me përvojat e tyre;
- të shkruajnë tekste të ndryshme në varësi të qëllimit dhe lexuesit;
- të shkruajnë pasi kanë mbledhur dhe përpunuar nga burime të ndryshme informacionin e nevojshëm;
- të zbulojnë kënaqësinë e të lexuarit të letërsisë dhe të bëhen të vetëdijshëm për shumësinë e mënyrave të perceptimit të botës përreth tyre;
- të zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura rreth sistemit gjuhësor të shqipes, të cilat do t'u mundësojnë të marrin pjesë suksesshëm në jetën e përditshme.

III. LINJAT DHE NËNLINJAT E PROGRAMIT

Linja: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	
1.	Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime
2.	Të dëgjuarit dhe të folurit në grup dhe në publik rreth teksteve të ndryshme.
3.	Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare
4.	Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde

Linja: Të lexuarit

Nënlinjat	
1.	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion
2.	Të lexuarit për dëshirë, për zhvillimin e ndjenjave dhe zgjim imagjinate
3.	Të lexuarit e llojeve dhe të gjinive letrare për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare
4.	Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje
5.	Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe

Linja: Të shkruarit

Nënlinjat	
1.	Të shkruarit funksional dhe për nevoja vetjake
2.	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë
3.	Njohuri rreth gjuhës

Linja: Njohuri rreth sistemit të gjuhës

Nënlinjat	
1.	Sintaksë
2.	Morfologji
3.	Leksikologji
4.	Kulturë gjuhe
5.	Drejtshkrim, pikësim.

Këto linja janë të njëjta për të gjitha klasat. Shpërndarja e orëve mësimore në klasat 1-5 është:

Klasat	1	2	3	4	5
Orë/javë	5	5	4	4	3
Orë gjithsej	150	150	120	120	90

IV.METODOLOGJIA

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre do të shërbejë për zhvillimin gjuhësor të nxënësve.

Mësuesit duhet të përditësojnë dhe përdorin çdo orë mësimi njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësit dëshirën për dijen, virtytet njerëzore, ambicien për të qenë të suksesshëm dhe aktivë në jetën e përditshme. Metoda, strategji dhe teknika të tilla, si: *diskutim për njohuritë paraprake, diagramë piramidale, lexim i drejtuar, imagjinata e drejtuar, parashikim me terma paraprake, harta e konceptit, rrjeti i diskutimit, pyetje autorit, ditaret e të nxënësve, pyetja sjell pyetjen* etj. shërbejnë si nxitje për nxënësit në procesin e të nxënësve dhe si garanci për rezultate të mira.

Përvetësimi i programit të gjuhës shqipe bëhet cilësor, kur mësuesi mundëson që:

- nxënësit të sjellin përvoja personale, interesa, qëndrime të caktuara ndaj dukurive gjuhësore në orën e mësimi;
- ora e mësimi të shoqërohet me rubrika të pasura, paraqitje skemash dhe grafikësh të thjeshtë të tilla, si ato që nxënësi has në jetën e përditshme, pasi ndërthurja e tyre synon ta mundësojë natyrshëm integrimin.
- rimarrja të jetë pjesë e mësimi të gjuhës shqipe, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
- nxënësve t'u jepen mundësi të dinë më shumë për dukuritë dhe ligjësitë gjuhësore dhe letrare.
- t'u jepet përparësi ushtrimeve, duke e kaluar mësimdhënien nga riprodhuese, në një mësimdhënie ku nxënësi kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon, provon dhe sintetizon.
- planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla, si; të folurit në grupe të vogla, të lexuarit shprehës dhe recitimi, të shkruarit, të shkruarit për qëllime të ndryshme dhe në fusha të ndryshme të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimi.

- punët me shkrim të tipit shkrim i lirë, përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruari, edhe pse të thjeshta, të jenë të paraprirë nga njohje, analiza, imitim krijimesh të të njëjtës natyrë, shkëputur nga trashëgimia jonë dhe ajo botërore.
- kërkesa për punë me shkrim për çdo temë mësimi në procesin mësimor, të mos varet apo plotësohet vetëm nga orët e veçanta të planifikuara për to në program, por doemos të bëhet pjesë përbërëse e shtjellimit të plotë të temës përkatëse, duke shtuar edhe kërkesa që lidhen me modelimin e shkrimit.

Shënim: Nëse orët e mësimi zhvillohen me 1-2 nxënës të ngjuar, atëherë mësuesi nuk përdor veprimtarinë në grupe, por punën në çift. Në rastet, kur klasat me fëmijë të ngjuar kanë më shumë nxënës, atëherë përdor veprimtaritë në grupe të vogla (3-6 nxënës).

V. UDHËZIME PËR PËRFAQËSIMIN E PJESËVE LETRARE DHE JOLETRARE

Gjatë mësimi të gjuhës shqipe nga klasa e parë deri në klasën e pestë nxënësit do të lexojnë dhe shkruajnë tekste letrare dhe joletrare.

Përsa i përket përfaqësimit të teksteve letrare dhe teksteve joletrare, këshillohet të respektohen afërsisht raportet: 70% me 30%

Për tekstet letrare, udhëzohet që të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe botërore në përshtatje me moshën dhe zhvillimin e nxënësve, të cilat të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës. Programi i gjuhës shqipe në fushën e të lexuarit, gjithashtu, parashtron përfshirjen e pjesëve letrare që mbulojnë:

- folklorin;
- letërsinë shqipe të periudhave të ndryshme;
- letërsinë botërore të periudhave të ndryshme.

Njëkohësisht këshillohet që nxënësit të lexojnë dhe analizojnë vepra dhe fragmente nga gjini të ndryshme letrare. Më konkretisht, në klasat 1- 5 këshillohet të respektohen raportet: 70% prozë, 30% poezi dhe dramë.

VI. INTEGRIMI

Një nga parimet kryesore mbi të cilat ndërtohet lënda e gjuhës shqipe është parimi i integritimit, çka do të thotë që duhet të ketë një ndërthurje të linjave dhe nënlinjave brenda orëve mësimore. Nuk duhet të ketë asnjëherë ndarje të plota mes linjave të programit pasi ato rrjedhin nga njëra-

tjetra dhe zhvillohen së bashku. Natyrisht, në orë të ndryshme mësimore linjat kanë pesha të ndryshme. P.sh. në një orë pune me shkrim, qëllimi i orës së mësimi përqendrohet tek të shkruarit.

Lënda e gjuhës shqipe duhet integruar edhe me lëndë të tjera mësimore në arsimin bazë. Kjo do të thotë që zbatuesit e këtij programi duhet të realizojnë parimin e integritit të njohurive dhe aftësive të gjuhës shqipe me njohuri dhe aftësi të fushave të tjera të dijeve, të tilla si: edukimi muzikor, edukimi figurativ, historia, gjeografia, gjuha e huaj, matematika, aftësimi teknologjik etj.

VII. VLERËSIMI

Roli kryesor i vlerësimit është të përmirësojë të nxënit. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e objektivave të programit për secilën klasë, si dhe u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të bëjnë propozime për përmirësimin e programeve.

Në përzgjedhjen e praktikave të vlerësimit, përcaktimin e kohës së përshtatshme për vlerësim dhe përzgjedhjen e materialeve që do të vlerësohen duhet patur parasysh:

- përcaktimi i qëllimit dhe strategjisë së vlerësimit;
- përzgjedhja e veprimtarive që mundësojnë demonstrimin e arritjes së objektivave;
- përdorimi i vlerësimit për të verifikuar çfarë dinë aktualisht nxënësit;
- besimi se të gjithë nxënësit mund t'i përmirësojnë arritjet;

Vlerësimi i nxënësve ndahet në tre tipa kryesorë: vlerësimi diagnostikues, vlerësimi formues, vlerësimi përmbledhës.

Gjatë zbatimit të programit nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë edhe në grup, për kryerjen e detyrave të cilat mund të zgjidhen me këtë metodë pune. Në këto raste mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit, në tërësi dhe të secilit nxënës, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë (ose me fjalë dhe shprehje) të nxënësve në çdo orë mësimi dhe të vendosë nota (ose fjalë dhe shprehje) në regjistër për secilën prej tyre. Nga ana tjetër vlerësimi i nxënësve duhet të jetë ritmik.

Komponentët e vlerësimit janë vlerësim me gojë dhe vlerësim me shkrim. Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim. Mësuesi e vlerëson nxënësin me notë (ose fjalë

dhe shprehje) për parashtrimet me gojë, në testimet periodike me shkrim dhe në punët me shkrim, të zhvilluara vetë ose në grup.

Mësuesi planifikon teste periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimi për të vlerësuar nivelin e arritjeve të nxënësve. Një formë e vlerësimit me shkrim nga nxënësit janë edhe testimet semestrale dhe përfundimtare.

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikrat e reja sot orientojnë vendosjen e kritereve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij. Mësuesi duhet ta ndjekë gjithë procesin e të shkruarit që nga planifikimi dhe deri tek rishikimi dhe redaktimi. Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve. Ato duhet të jenë të tilla që t'i motivojnë ata. Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë punë me shkrim, detyra tematike, projekte lëndore e ndërlëndore etj. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësi, mësuesi rekomandon.

Detaje që kanë lidhje me vlerësimin në arsimin bazë (sidomos për klasat 1-3) gjenden në dokumente zyrtare të posaçme për këtë.

KLASA 1

ABETARE

30 javë x 5 orë në javë= 150 orë

HYRJJE

Lënda e abetares zhvillohet në tri faza:

Faza e parë lidhet me periudhën përgatitore për lexim-shkrimin. *Periudha përgatitore* zakonisht shoqërohet me fletore pune, veprimtari dhe materiale të tjera didaktike me ndikime të drejtpërdrejta e të dallueshme në lexim-shkrimin fillestar.

Faza e dytë lidhet me fitimin e shprehive elementare të teknikës së lexim-shkrimit. Ajo zakonisht shoqërohet me tekstin *e abetares* dhe fletore pune të përshtatshme për këtë tekst. Njëkohësisht, shoqërohet edhe me mjete didaktike që e lehtësojnë mësimin e lexim-shkrimit.

Faza e tretë lidhet me përforcimin e teknikës së lexim-shkrimit. Kjo periudhë përforcon shprehitë e lexim-shkrimit fillestar të nxënësve, duke i pajisur ata edhe me njohuri të thjeshta gjuhësore. Ajo shoqërohet me *pjesë leximi të shkurtra e tërheqëse dhe me ushtrime gjuhësore*.

Metodologjia e zbatimit të këtij programi lidhet ngushtë me veprimtaritë që duhet të udhëheqë mësuesi në bashkëpunim me nxënësit, për ta realizuar dhe përvetësuar atë plotësisht.

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Nr.	Fushat e studimit	Orë mësimore
1.	Zhvillimi i aftësive të folurit dhe të dëgjuarit	45 orë
2.	Zhvillimi shprehive fillestare të lexuarit	45 orë
3.	Zhvillimi i shprehive fillestare të shkruarit	45 orë
4.	Njohuri rreth gjuhës	15 orë

ZBËRTHIMI I PROGRAMIT

LINJAT'	FAZAT	ORËT
	Periudha përgatitore (parabetare)	2 javë x 5 orë = 10 orë
D ,F	Shqiptimi i tingujve të shqipes. Shkrimi i shkronjave.	
D ,F	Zhvillimi i të folurit. Pasurimi i fjalorit.	
L	Lexim global dhe shkrimi i fjalëve dhe fjalive.	
Sh	Shkrimi elementeve të shkronjave dhe i fjalëve e fjalive të thjeshta në mënyrë globale.	
	Periudha e abetares	25 javë x 5 orë =125 orë
D, F, L, Sh	Punimi i 6 shkronjave të para. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	
D, F, L, Sh	Rimartje e 6 shkronjave të para.	
D, F, L, Sh	Punimi i 6 shkronjave të dyta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	
D, F, L, Sh	Rimartje e 6 shkronjave të dyta.	
D, F, L ,Sh	Punimi i 6 shkronjave të treta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	
D, F, L, Sh	Rimartje e 6 shkronjave të treta.	
D, F, L , Sh	Punimi i 6 shkronjave të katërta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	
D, F, L, Sh	Rimartje e 6 shkronjave të katërta.	
D, F, L ,Sh	Punimi i shkronjave të pesta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	

* Linjat “Të dëgjuarit” dhe “Të folurit” shënohen shkurtimisht me D dhe F; Linjat “Të lexuarit” shënohet shkurtimisht me L dhe linja “ Të shkruarit” me Sh.

D, F, L, Sh	Rimarrje e 6 shkronjave të pesta.	
D, F, L, Sh	Punimi i shkronjave të gjashta. Fjalor, zhvillim të foluri, lexim, ushtrime, shkrim.	
D, F, L, Sh	Rimarrje e 6 shkronjave të fundit.	
	Pasabetare (përforcimi i teknikës së lexim-shkrimit)	3 javë x 5 orë = 15 orë
L	Lexime.	
D, F, L, Sh	Ushtrime gjuhësore.	
GJITHSEJ		150 orë

OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit e të folurit

Linja	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të flasë qartë e bukur në gjuhën shqipe; • të artikulojë qartë tingujt e shqipes; • të dëgjojë në grupe të vogla; • të dëgjojë me vëmendje dhe t'u përgjigjet bashkëfolësve brenda temës për të cilën flitet; • të pasurojë në vazhdimësi fjalorin dhe të folurit bazë në përkatësi me moshën; • të tregojë vëmendje gjatë bisedave që lidhen me jetën dhe veprimtarinë e tij; • të aftësohet për të hyrë në bashkëbisedim me të tjerë bashkëfolës dhe bashkëmoshatarë; • të shqiptojë drejt fjalët e gjuhës shqipe; • të japë sqarime dhe udhëzime të thjeshta, kur i kërkohet;

	<ul style="list-style-type: none"> • të dëgjojë me vëmendje bashkëbiseduesin; • të ritregojë përmbajtje të thjeshta tregimesh apo historish që ka lexuar vetë apo ka dëgjuar nga të tjerët; • të mbajë qëndrimin e duhur të trupit dhe të përdorë gjestet e duhura; • të bëjë pyetje, kur është e nevojshme; • të kërkojë sqarime, kur ka nevojë për to.
--	---

LINJA: Të lexuarit

Linja	Objektivat
Të lexuarit	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të fitojë shprehinë e teknikës së të lexuarit; • të lidhë tingullin me shkronjën përkatëse; • të lexojë fjalë e grupe fjalësh në mënyrë globale (30-40 fjalë e grupe fjalësh); • të lexojë globalisht fjalë të tilla, si: <i>libër, faqe, titull, shkronjë etj.</i>; • të dallojë tekstin nga fjalia dhe fjala; • ta ndajë tekstin në fjali dhe në fjalë; • të dallojë bashkëtingëlloret dhe zanoret; • të dallojë dhe të thotë përmendësh shkronjat e alfabetit; • të lexojë saktë shkronjat dyshe të alfabetit; • të lexojë në mënyrë të kuptimshme; • të ritregojë thjesht përmbajtjen e pjesëve që lexon; • të dallojë terma letrarë të tillë, si: <i>varg, poezi, tregim, përrallë, libër, titull etj.</i>; • të luajë në role pjesë të dramatizuara; • të zhvillojë imagjinatën duke u nxitur nga figura apo tregime me

	<p>figura dhe ilustrime;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të fillojë të lexojë edhe tekste joletrare; • të shfaqë dëshirë për të lexuar tekste të tipit: <i>gjëgjëzë, përrallë, fjalë të urta etj.</i>; • të shfaqë dëshirë për të lexuar tekste të tipit histori (<i>prozë dhe poezi</i>); • të respektojë gjatë leximit shenjat e pikësimit, si: <i>pika, presja, pikëpyetja, pikëçuditësja</i>; • të lexojë me intonacionin e duhur fjalitë dëftore dhe pyetëse; • të lexojë rreth 45-100 fjalë në minutë; • të japë shpjegime të thjeshta për tekstet që lexon; • të dallojë në një histori: <i>personazhet, vendin dhe kohën</i> kur zhvillohen ngjarjet.
--	--

LINJA: Të shkruarit

Linja	Objektivat
Të shkruarit	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë fjalë dhe shprehje globale; • të shkruajë shkronjat e dorës të gjuhës shqipe; • të ndajë fjalët në rrokje; • të shkruajë fjali të thjeshta; • të shkruajë me të diktuar fjali dhe paragrafë të thjeshtë; • të plotësojë fjalët në vendet ku mungojnë; • të emërtojë objekte dhe dukuri për të cilat dëgjojnë, flasin apo lexojnë, të tilla si: <i>fluturim, re, shi, këngë, sport</i>;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë letra e kartolina të thjeshta duke parë dhe kopjuar modele; • të përshkruajë përvoja vetjake; • të shprehë mendime e ndjenja vetjake; • të shkruajë drejt dhe pa gabime drejtshkrimore; • t’u përgjigjet me shkrim pyetjeve që u bëhen; • të shkruajë tregime të thjeshta; • të përdorë shenjat e pikësimit: pikën (.) dhe pikëpyetjen (?).
--	---

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Linja	Objektivat
Njohuri rreth gjuhës	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë tingujt dhe shkronjat e gjuhës shqipe; • të dallojë sipas intonacionit fjalinë pohore dhe pyetëse; • të dallojë sipas intonacionit fjalinë pohore dhe mohore; • të dallojë emrat e njerëzve dhe të sendeve; • të dallojë emrat kur janë në njëjës dhe shumës; • të dallojë emrat kur janë femërore dhe mashkullore; • të gjejë dhe të shkruajë fjalët që tregojnë si janë njerëzit, sendet, kafshët; • të dallojë, nën udhëheqjen e mësuesit, fjalët që tregojnë veprime (foljet). • të dallojë fjalë që tregojnë veprime që janë kryer më parë, kryhen tani dhe do të kryhen më pas; • të përdorë shkronjën e madhe tek emrat e njerëzve; • të përdorë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë;

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">• të përdorë saktë shenjat e pikësimit pikën (.) dhe pikëpyetjen (?). |
|--|---|

KLASA 2

Gjuhë shqipe

30 javë x 5 orë në javë= 150 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Linja		Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	15	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	75	Prozë e poezi
			Përralla
			Tregime
			Poezi
			Gjëegjëza, fabula
3.	Të shkruarit	25	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	- Tema nga jeta reale dhe veprimtaritë e përditshme: <i>mësimi, ëndrrat, familja, shkolla, shoqëri.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të përgjigjet në përshtatje me atë që i kërkohet; • të japë informacione e mesazhe të shkurtra; • të japë udhëzime e orientime me fjalë të thjeshta.
Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	- Tema që lidhen me çështjet shoqërore që u përkasin dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup; • të diskutojë në grup për çështje të caktuara; • të luajë role të thjeshta; • të respektojë mendimet dhe idetë e shokëve.
Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	- Tekste të gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes nxënësit.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të dëgjojë dhe të flasë për tekste të ndryshme që janë në përshtatje me moshën e tij dhe që kanë strukturë e gjuhë të qartë; • t'u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së teksteve dhe figurave

		që shikon.
Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare	- Tema të larmishme që trajtohen në lloje e gjini të veçanta letrare, si: <i>vjersha, përralla, tregimi dhe gjëgjëza.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë vjershën, përrallën, tregimin dhe gjëgjëzën; • të dallojë intonacionin e zërit në një vjershë, përrallë dhe tregim; • të gjejë hyrje të reja në një përrallë ose tregim.
Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	- Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë, shprehje dhe terma nga fusha të ndryshme tematike.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të shqiptojë saktë tingujt dhe fjalët; • të dallojë kuptimin e parë të fjalëve më të përdorshme; • të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje të reja.

LINJA: Të lexuarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	- Tekste letrare dhe joletrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë të tillë që të kuptojë pjesën; • të bëjë pyetje për t'u sqaruar rreth informacionit të marrë; • Të japë udhëzime të thjeshta.
Të lexuarit për	- Pjesë që u ngjallin nxënësve	Nxënësi duhet:

dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	emocione, dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>loja, fitorja, humbja, dashuria, bashkëpunimi, ndihma, ndershmëria etj.</i>	<ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë; • të tregojë personazhet e tij të preferuar, duke treguar arsyen; • të krijojë lidhje ndërmjet filmave, figurave dhe ngjarjeve të lexuara.
Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste që përmbajnë përshkrime të mjediseve dhe njerëzve që marrin pjesë në to. - Tekste që i nxisin nxënësit t'i reflektojnë idetë në mënyra të ndryshme: me anë të vizatimeve, shkrimeve, poezive etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ritregojë me fjalë të thjeshta përmbajtjen e pjesës së lexuar; • të tregojë 2-3 karakteristika të personazheve kryesore.
Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare, si: <i>përralla, tregimi, vjersha dhe gjëgjëza.</i> - Pjesë në të cilat dallohen tipare të llojeve e gjinive të ndryshme që nga mënyra e organizimit të faqes, 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare; • të dallojë elemente të tilla, si: <i>paragrafi, rreshti, strofa, vargu, hyrje, mbyllje;</i> • të dallojë vjershën nga tregimi.

	të përzgjedhjes së figurave, gjuhës, titullit etj.	
Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që duke u lexuar me zë të lartë ngjallin emocion te dëgjuesit. - Pjesë të transmetuara në radio e televizion ose të interpretuara nga mësuesi që duhen imituar nga nxënësit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me zë të lartë me intonacionin e duhur; • të recitojë me zë të lartë 2 strofa të vjershës që pëlqen; • të imitojë zërin e një personazhi të tregimit ose të përrallës së lexuar; • të luajë në rol personazhin e preferuar.
Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tilla, si: <i>autor, titull, faqe poezi, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëgjëzë, personazh, hyrje, mbyllje, ide, mesazh.</i> 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë terma të tilla, si: <i>autor, titull, faqe vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, rol, figurë, gjëgjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, , në pjesët që lexon;</i> • të respektojë gjatë të lexuarit shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen.

LINJA: Të shkruarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Të shkruarit funksional	<ul style="list-style-type: none"> - Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla, si: këshilla, porosi të thjeshta. - Fragmente shkrimesh nga revistat dhe gazetat që përmbajnë shkrime të karakterit funksional. - Modele gjysmë të gatshme në të cilat nxënësit do të plotësojnë fjalët dhe shprehjet që mungojnë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kopjojë saktë porosi e këshilla të thjeshta; • të plotësojë saktë modele gjysmë të gatshme, duke u ndihmuar nga fjalë apo pyetje ndihmëse; • të shkruajë këshilla e porosi të thjeshta për të tjerët.
Të shkruarit personal (për nevoja vetjake)	<ul style="list-style-type: none"> - Modele letrash të thjeshta. - Modele urimesh e kartolinash të dërguara në raste të ndryshme. - Modele planesh të thjeshta të bashkëmoshatarëve. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kopjojë saktë modele urimesh e kartolinash; • të shkruajë vetë një urim dhe një kartolinë; • të hartojë një plan të thjeshtë të regjimit ditor.
Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste me portrete njerëzish dhe pamje nga peizazhi i natyrës dhe mjedise të ndryshme. - Piktura të thjeshta dhe fotografi që 	<ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë objekte, njerëz e kafshë të njohura e të dashura për të; • të shkruajë një ndodhi të shkurtër rreth bëmave të personazheve fantastike.

	<p>nxisin imagjnatën e nxënësve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekste me personazhe fantastike me fuqi mbinatyrore ose të zakonshëm që kryejnë veprime të jashtëzakonshme. 	
Njohuri rreth gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tilla, si: këshillë, njoftim, letër, porosi, kartolinë, personazh fantastik, histori, krijim, titull, mbyllje etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një udhëzim, urim, kartolinë etj.

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Morfologji	<p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinia femërore dhe mashkullore. - Numri njëjës dhe shumës. <p>Folja</p>	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalë që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh; • të dallojë emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore, nisur nga mbaresa e tyre;

	<ul style="list-style-type: none"> - Koncepti i kohës: dje – sot – nesër. <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinia femërore e mashkullore. - Numri njëjës e shumës. <p>Përemri vetor</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojë emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës • të dallojë foljet; • të dallojë kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti: dje-sot-nesër; • të dallojë mbiemrin si fjalë që tregon një karakteristikë të emrit. • të dallojë mbiemrin e nyjshëm të gjinisë femërore dhe mashkullore, nisur nga nyja e përparme; • të dallojë numrin e mbiemrit, nisur nga ndryshimi i nyjes së përparme; • të dallojë përemrat vetorë: unë, ti, ai (ajo), ne, ju, ata (ato).
Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> - Teksti dhe fjalia. - Fjalia . - Zhvendosja e fjalëve brenda fjalisë. - Zgjerimi dhe zvogëlimi i fjalisë. - Llojet e fjalive dëftore pyetëse, pohore, mohore. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë paragrafët në një tekst; • të dallojë fjalitë e një paragrafi; • të rendisë fjalitë në një tekst të shkurtër; • të ndërtojë një fjali të thjeshtë; • të zhvendosë fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj; • të shtojë fjalë në një fjali të thjeshtë, pa prishur kuptimin e saj; • të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë, pa prishur kuptimin e saj; • të dallojë fjalinë dëftore;

		<ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalinë pyetëse; • të dallojë fjalinë pohore; • të dallojë fjalinë mohore.
Leksikologji	Fjalët e thjeshta dhe të përbëra.	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalët e thjeshta nga fjalët e përbëra; • të krijojë fjalë të përbëra, kur t'i jepen fjalët përbërëse.
Drejtshkrim dhe pikësim	<ul style="list-style-type: none"> - Shkronjat e alfabetit. - Fjalët dy dhe trirrokëshe. - Shkronja e madhe. - Përdorimi i pikës. - Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. - Numërorët 1-20. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë saktë dhe bukur shkronjat e vogla dhe të mëdha të gjuhës shqipe; • të shkruajë saktë fjalë me dy dhe tri rrokje; • të përdorë saktë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë dhe tek emrat e njerëzve; • të vendosë pikën në fund të fjalisë; • të ndajë fjalët në fund të rreshtit; • të shkruajë drejt numërorët nga 1-20; • të shkruajë bukur e pa gabime drejtshkrimore tekste të shkurtra me të kopjuar dhe me diktim.

KLASA 3

Gjuhë shqipe

30 javë x 4 orë në javë= 120 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Linja		Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	10	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	50	Prozë e poezi
			Përralla
			Tregime
			Poezi
			Gjëegjëza dhe fabula
3.	Të shkruarit	25	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Drejtshkrim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit e të folurit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	Tema nga jeta reale dhe veprimtaritë e përditshme si: - <i>familja, shkolla, shoqëria, të afërmit mjedisi.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të përgjigjet në përshtatje me atë që i kërkohet; • të japë informacione e mesazhe të shkurtra; • të ndjekë radhën e veprimeve që do të kryhen në një veprimtari; • të japë orientime të thjeshta, si: <i>urdhra, udhëzime, porosi.</i>
Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	- Tema që lidhen me çështje shoqërore. - Tema që u përkasin marrëdhënieve ndërmjet njerëzve, si: <i>miqësia, mosmarrëveshjet, komunikimi, të drejtat, sjellja në grup, veprimtaritë e përbashkëta.</i>	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup; • të diskutojë në grup për çështje të caktuara; • të marrë role të ndryshme në grupe të vogla; • të respektojë mendimet dhe idetë e shokëve.
Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	- Tekste të gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes nxënësit, si: <i>përralla, tregime, poezi, fabula e gjëgjëza.</i> - Biseda për tekste të ndryshme që kanë	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none"> • të flasë për tekste të ndryshme që janë në përshtatje me moshën e tij; • t'u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së teksteve dhe figurave që shikon.

	lexuar ose kanë dëgjuar.	
Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutime për gjini të veçanta letrare, si: <i>poezi, përralla, tregime dhe gjëegjëza.</i> - Pjesëmarrje në lojë me role. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë llojet letrare si: poezi, gjëegjëza, përralla, tregimi dhe fabula; • të ndryshojë intonacionin e zërit në një vjershë, përrallë dhe tregim; • të gjejë titull të ri për një tregim ose përrallë.
Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë nga fusha të veprimtarisë jetësore të nxënësve. - Pasurimi i fjalorit me shprehje dhe terma nga fusha të ndryshme tematike. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shqiptojë saktë tingujt dhe fjalët; • të dallojë kuptimin e parë të fjalëve më të përdorshme; • të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje.

LINJA: Të lexuarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
----------	----------	------------

Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste letrare dhe joletrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë të kuptimshme; • të bëjë pyetje rreth tekstit për të marrë informacionin e duhur; • të japë detaje shtesë rreth informacionit apo udhëzimit të marrë.
Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që u ngjallin nxënësve emocione, dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>shkolla, sporti, fitorja, dashuria, veprimtaritë jashtëshkollore, bashkëpunimi, ndihma, ndershmëria, besnikëria etj.</i> - Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë e tyre të tregimeve dhe të përrallave. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me dëshirë dhe me ndjenjë tekste të natyrave të ndryshme; • të tregojë tipare të personazheve që pëlqen; • të krijojë lidhje ndërmjet figurave dhe historive të lexuara.
Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste letrare dhe joletrare të pasura me të dhëna e detaje kryesore, që i nxjerrin qartë idetë dhe mesazhet që përmbajnë. - Tekste që përshkruajnë mjedise dhe njerëz që marrin pjesë në to. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të tregojë brendinë e pjesës që lexon; • të nxjerrë pikat e planit; • të gjejë mesazhin e pjesës që lexon.
Të lexuarit e	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të llojeve dhe gjinive të ndryshme 	<p>Nxënësi duhet:</p>

llojeve dhe gjinive letrare	letrare, si: përralla, tregime, poezi, drama dhe gjëegjëza.	<ul style="list-style-type: none"> • të lexojë pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare; • të respektojë elemente të stilit dhe të gjuhës, të tilla si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu; • të shprehë pëlqimin ose mospëlqimin për lloje e gjini të veçanta.
Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që ngjallin emocion te lexuesit. - Respektimi i teknikës së recitimit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë të pjesëve në poezi apo në prozë; • të recitojë me zë të lartë poezitë duke respektuar rregullat e mësuara; • të luajë në role personazhe të tregimeve dhe të përrallave që ka lexuar.
Të lexuarit në praktikim të njohurive rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që pasurojnë të folurit e nxënësve me terma të tillë, si: <i>autor, titull, faqe, poezi, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, njoftim, rol, fjalor, dialog, mesazh, pikë kulmore.</i> 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë terma të tilla, si: <i>autor, titull, faqe, poezi, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, figurë, gjëegjëzë, personazh</i>, në pjesët që lexon; • të respektojë gjatë të lexuarit shenjat e pikësimit: <i>pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen.</i>

LINJA: Të shkruarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Të shkruarit funksional	<ul style="list-style-type: none"> - Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla, si: <i>njoftime, udhëzime dhe porosi të thjeshta.</i> - Modele gjysmë të gatshme në të cilat nxënësit do të plotësojnë fjalët dhe shprehjet që mungojnë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë saktë me të kopjuar <i>njoftime, udhëzime e porosi</i> të thjeshta; • të shkruajë saktë me të plotësuar <i>njoftime, udhëzime e porosi</i> të thjeshta; • të shkruajë porosi të thjeshta për të tjerët; • të mbajë shënime të shkurtra për udhëzime, këshilla e porosi që i interesojnë, të dhëna përmes telefonit apo bisedave të drejtpërdrejta.
Të shkruarit për nevoja vetjake	<ul style="list-style-type: none"> - Modele <i>letrash të thjeshta për veten dhe të tjerët.</i> - Modele <i>urimesh e kartolinash</i> të dërguara në raste të ndryshme. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kopjojë saktë modele <i>urimesh, kartolinash e letrash</i> të thjeshta; • të shkruajë vetë një urim, kartolinë dhe një letër të thjeshtë;

	<ul style="list-style-type: none"> - Plane të thjeshta. 	<ul style="list-style-type: none"> • të hartojë plane të thjeshta të regjimit ditor.
Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste me <i>portrete njerëzish</i> dhe pamje nga <i>peizazhi i natyrës dhe mjedise të ndryshme</i>. - <i>Përshkrime pikturash dhe fotografish</i> që nxisin imagjinatën e nxënësve. - Përshkrimi i kafshëve nga fabula të njohura, si: ujku, luani etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë objekte, kafshë e njerëz të njohur e të dashur për të me detaje, që përfshijnë pamjen e jashtme dhe cilësi të tjera; • të shkruajë mbyllje të tjera për një ngjarje; • të shkruajë tregime të shkurtra, orientuar nga figura, ilustrime modele dhe fjalë kyçe.
Njohuri rreth gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tillë, si: <i>udhëzim, njoftim, letër, porosi, kartolinë, personazh fantastik, histori, krijim, titull, mbyllje, hapje, mbyllje, paragraf, fjali, emra njerëzish etj.</i> 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një <i>udhëzim, urim, kartolinë, letër, krijim, përshkrim, titull, shenja pikësimi, krahasim, porosi, recetë, kërkesë etj.</i>

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> - Teksti dhe fjalia. - Grupet kryesore në fjali. - Grupet e fjalëve plotësuese. - Shndërrime brenda fjalisë. - Grupe fjalësh të qëndrueshme. - Grupet fjalësh të lëvizshme. - Llojet e fjalive (dëftore, pyetëse). - Fjalia pohore dhe mohore. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë paragrafët në një tekst; • të gjejë fjalitë e një paragrafi; • të njihet me strukturën e fjalisë; • të dallojë grupet kryesore në fjali; • të dallojë grupet plotësuese në fjali; • të zhvendosë fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj; • të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë, pa prishur kuptimin e saj; • të dallojë fjalinë dëftore; • të dallojë fjalinë pyetëse; • të dallojë fjalinë pohore; • të dallojë fjalinë mohore.
Morfologji	<p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emrat e përveçëm dhe emrat e përgjithshëm. - Gjinia e emrit. - Numri i emrit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalë që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh; • të dallojë emrat e gjinisë femërore nga të gjinisë mashkullore, nisur nga mbaresat e tyre;

	<p>Mbiemri</p> <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tri njësitë kohore të foljes. <p>Ndajfolja</p>	<ul style="list-style-type: none"> • të dallojë emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës. • të dallojë mbiemrin; • të përcaktojë kohën e foljeve sipas tri njësive bazë: dje-sot-nesër; • të përdorë foljet e kohës së tashme në fjali, duke përdorur fjalën sot, tani; • të përdorë foljet e kohës së shkuar në fjali, duke përdorur fjalën dje; • të përdorë foljet e kohës së ardhme në fjali, duke përdorur fjalën nesër; • të dallojë ndajfoljen.
Leksikologji	<p>Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> - Parashtesa dhe prapashtesa. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të gjejë parashtesat <i>-pa, -ri</i> - në fjalë të njohura; • të gjejë prapashtesat: <i>-tar, -tor</i> në fjalë të njohura.
Drejtshkrim dhe pikësim	<ul style="list-style-type: none"> - Shenjat e pikësimit ., ?, !. - Shkrimi i fjalëve mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s</i>. - Emrat e përveçëm. - Ushtrime drejtshkrimore. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë drejt shenjat e pikësimit në fund të fjalisë(., ?, !); • të shkruajë saktë fjalët mohuese <i>nuk</i> dhe <i>s'</i>; • të shkruajë saktë mohuese askush, kurrkush, asnjë, asnjeri, asnjëra, kurrkund, kurgjë etj.;

		<ul style="list-style-type: none">• të drejtshkruajë emrat e përveçëm;• të kopjojë tekste të ndryshme;• të drejtshkruajë gjatë diktimeve e vetëdiktimeve.
--	--	---

KLASA 4

Gjuhë shqipe

30 javë x 4 orë në javë= 120 orë

STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Linja		Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	10	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	50	Prozë e poezi
			Përralla
			Tregime
			Poezi
			Gjëegjëza, fabula
3.	Të shkruarit	20	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	40	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none">- Tema nga jeta e ditës: ëndrrat, familja, shkolla, shoqëria.- Tema nga koha e lirë: lojra, veprimtari sportive, biblioteka, radio, TV, gazeta, interneti, udhëtime, shëtitje, turizmi, mjedisi, jeta në shkollë, zbavitje etj.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none">• të dëgjojë me vëmendje dhe të marrë pjesë në komunikim duke dhënë informacione, udhëzime dhe orientime të thjeshta;• të pyesë për çështje e rrethana të veçanta që i interesojnë.
Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla e të gjera.	<ul style="list-style-type: none">- Tema që lidhen me çështjet shoqërore si: paqja, të drejtat, miqësia, konfliktet, toleranca, komunikimi.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none">• të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup;• të përshkruajë ngjarje e situata nga jeta e tij;• të diskutojë në grup për çështje të caktuara;• të luajë rolet e caktuara në grupe të vogla dhe të mëdha;• të respektojë mendimet e të tjerëve.
Të dëgjuarit dhe të folurit	<ul style="list-style-type: none">- Tema të ndryshme në tekste të gjinive e	Nxënësi duhet:

rreth teksteve të ndryshme.	llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes fëmijët.	<ul style="list-style-type: none"> • të flasë për tekste të ndryshme, si: tregime, poezi, përralla, fabula, fjalë të urta, poezi, gjëgjëza të përshtatshme për moshën e tij; • t’u pergjigjet pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara ose të dëgjuara nga të tjerët; • të dallojë ndryshime të thjeshta formale në tekstet që lexon.
Të dëgjuarit dhe të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë nga lloje e gjini të veçanta letrare, si: poezi, përralla, tregime, gjëgjëza, fabula, fjalë të urta. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë intonacionin e zërit në përshtatje me pjesën që lexon; • të interpretojë në lojën me role pjesë të ndryshme; • të përdorë rregullat e teknikës së recitimit në përshtatje me tekstin.
Të folurit duke përdorur njohuritë rreth gjuhës standarde.	<ul style="list-style-type: none"> - Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë nga fusha të aktivitetit jetësor. - Pasurimi i fjalorit me fjalë e shprehje. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të drejtshqiptojë saktë të gjithë tingujt e fjalët; • t’i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin në kontekste të ndryshme; • të pasurojë fjalorin me fjalë e shprehje të reja;

--	--	--

LINJA: Të lexuarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Të lexuarit për të kuptuar tekstin e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste letrare dhe joletrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë duke respektuar shenjat e pikësimit; • të bëjë pyetje rreth tekstit për të marrë informacionin e duhur; • të dallojë informacionin më të rëndësishëm nga informacioni i dorës së dytë.
Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që u ngjallin nxënësve emocione, dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>shkolla, loja, paqja, toleranca, të drejtat, detyrat, përgjegjësitë, dashuria, bashkëpunimi, vendlindja, bota etj.</i> - Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë dhe heronjtë e tyre. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë me interes dhe dëshirë tekste të natyrave të ndryshme; • të përdorë tri format e leximit shprehës: vetjak, leximin e dramatizuar (me role) dhe leximin kolektiv; • të krijojë lidhje ndërmjet figurave (ose ilustrimeve) dhe historive të lexuara; • të tregojë tiparet e personazheve që pëlqen;

Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e tekstit.	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste letrare dhe joletrare të pasura me të dhëna e detaje kryesore, që i nxjerrin qartë idetë dhe mesazhin e pjesës. - Tekste që përshkruajnë mjedise, njerëz, kafshë, bimë të vendeve të ndryshme në kohëra të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> • të tregojë brendinë e pjesës që lexon; • të ndajë pjesën në fragmente të veçanta; • të gjejë pikat e planit të pjesës që lexon.
Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare. - Pjesë në të cilat dallohen tipare të llojeve e gjinive të ndryshme që nga mënyra e renditjes së fjalëve, e organizimit të faqes, e përzgjedhjes së figurave, gjuhës, titullit, paragrafëve, vargut. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë elemente të tilla, si: paragrafi, rreshti, strofa, vargu; • të dallojë prozën nga poezia.
Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që duke u lexuar në mënyrë shprehëse ngjallin emocion te dëgjuesit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë, të pjesëve në poezi apo në prozë; • të demostrojë të lexuar me intonacion, ritëm dhe theks sipas llojit të tekstit , duke u bazuar në imitimimin e modeleve më të mira.
Të lexuarit në praktikim të	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që i pasurojnë të folurit e nxënësve me terma të tilla, si: autor, titull, faqe, 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të drejtshqiptojë gjithnjë të gjithë tingujt e fjalët;

njohurive rreth gjuhës standarde shqipe	vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, rol, figurë, gjëgjëzë, përgjigje, hyrje, mbyllje, ide, rol.	<ul style="list-style-type: none"> të përdorë gjithnjë drejt theksin, në fjalët e njohura apo të reja; të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve.
---	--	--

LINJA: Të shkruarit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të shkruarit me karakter funksional	<ul style="list-style-type: none"> Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla si: njoftime, përshkrime. Modele nga materiale të ndryshme të përshtatshme për këtë moshë (të karakterit informues). Modele gjysmë të gatshme ku nxënësi duhet të plotësojë fjali ose paragrafë që mungojnë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shkruajë sipas modeleve të dhëna njoftime e përshkrime; të japë informacione të shkurtra me shkrim; të plotësojë drejt paragrafë të modeleve të ndryshme; të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një këshillë për rregullin në klasë, për riqarkullimin e mbeturinave, formular, plan të thjeshtë pune apo veprimtarie, thirrje për veprime qytetare etj.
Të shkruarit për qëllime vetjake dhe më gjerë	<ul style="list-style-type: none"> Modele shkrimesh ku shprehen nevoja vetjake: kërkon ndihmë, jep përgjigje me shkrim. Modele shkrimesh ku bëhet fjalë për veprimtari të tilla si: një festë, një aktivitet etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shkruajë për të kërkuar ndihmë për çështje të ndryshme;

		<ul style="list-style-type: none"> • të japë një përgjigje me shkrim; • të plotësojë plane veprimtarish.
Të shkruarit për t'u shprehur me ndjenjë dhe me imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të ndryshme letrare me personazhe të dashur për nxënësit. - Përralla të shkurtra, legjenda, fabula etj. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë personazhe në krijime të imagjinatës popullore apo letrare; • të shkruajë mbi bazën e figurave dhe imagjinatës së tij tekste të shkurtra.

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Sintaksë	<ul style="list-style-type: none"> - Teksti dhe fjalia. - Grupet kryesore të fjalëve në fjali . - Përshtatja e foljes me kryefjalën. - Veprime brenda fjalive. - Grupe të lëvizshme dhe grupe të palëvizshme. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë paragrafët në një tekst; • të rendisë sipas rrjedhës logjike paragrafët në tekst; • të dallojë grupin e kryefjalës dhe grupin e foljes në një fjali;

		<ul style="list-style-type: none"> • të përshtasë foljen me kryefjalën; • të kryejë veprime me grupet e fjalëve në fjali.
Morfologji	<ul style="list-style-type: none"> - Emri i përgjithshëm dhe i përveçëm. - Lakimi i emrit. - Mbiemri i nyjshëm dhe i panyjshëm. - Folja kam dhe jam. - Ndajfolja. - Lidhëza. - Përemri pronor. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë emrin e përgjithshëm dhe të përveçëm; • të tregojë gjininë e emrit; • të dallojë mbiemrin e nyjshëm dhe të panyjshëm; • të tregojë gjininë e mbiemrit; • të dallojë foljet kam dhe jam me kuptim të mëvetësishëm në një fjali; • të përdorë foljet kam dhe jam në fjali; • të dallojë ndajfoljen në një fjali; • të dallojë lidhëzat; • të dallojë përemrin pronor.
Drejtshkrim dhe pikësim	<ul style="list-style-type: none"> - Fjalët me 3 rrokje. - Shkrimi i datës. - Shenjat e pikësimit (.) (?) (!). - Shkronja e madhe. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë qartë fjalë trirrokëshe; • të shkruajë korrektësisht datën; • të përdorë shenjat e pikësimit: pikë, pikëpyetje

	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtshkrimi i mbiemrave të nyjshëm. - Ushtrime drejtshkrimore. - Dikttime. 	<p>dhe pikëçuditëse në fund të fjalisë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë shkronjat e mëdha në fillim të fjalisë, te emrat e njerëzve dhe në raste të tjera të përdorimit të tyre; • të ndajë fjalët në fund të rreshtit; • të zbatojë rregullat drejtshkrimore gjatë shkrimit me të kopjuar, diktuar ose në krijime.
Leksikologji dhe fjalëformim	<ul style="list-style-type: none"> - Fjalët e thjeshta, të prejardhura dhe të përbëra. - Sinonimet dhe antonimet. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalë të thjeshta; • të dallojë fjalë të prejardhura; • të dallojë fjalë të përbëra; • të dallojë sinonimet dhe antonimet.
Kulturë gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> - Dialektet. - Gjuha standarde. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalët dialektore në një tekst të dhënë; • të dallojë fjalët e gjuhës standarde nga ato dialektore në një tekst të dhënë.

KLASA 5**Gjuhë shqipe****30 javë x 3 orë në javë= 90 orë****STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT**

Linja		Orë	
1.	Të folurit dhe të dëgjuarit	5	Gjuhë e folur
2.	Të lexuarit	35	Prozë , poezi, dramë
			Përralla
			Tregime
			Poezi
			Dramë
			Gjëegjëza, fabula
3.	Të shkruarit	15	Gjuhë e shkruar
4.	Njohuri rreth gjuhës	35	Sintaksë
			Morfologji
			Leksikologji
			Drejtshkrim dhe pikësim

OBJEKTIVAT DHE PËRMBAJTJA SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none">- Materiale me tematika nga fusha të ndryshme të veprimtarisë së përditshme në shkollë, familje, shoqëri.- Materiale të ndryshme kryesisht joletrare që paraqesin interes për nxënësit.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none">• të pyesë dhe të përgjigjet për raste kur i kërkohet t’u japë informacion të tjerëve dhe anasjelltas;• të kërkojë informacion shtesë për rastet kur është i paqartë për çështje të caktuara;• të përdorë fjalorin dhe sintaksën e duhur në rastet kur pyet ose përgjigjet.
Të dëgjuarit dhe të folurit në grupe të vogla e të gjera.	<ul style="list-style-type: none">- Tema që lidhen me çështjet shoqërore në përshtatje me moshën dhe që u përkasin fushave të ndryshme të marrëdhënieve njerëzore: mes pjesëtarëve të familjes, mes shokëve, me mësuesit.	Nxënësi duhet: <ul style="list-style-type: none">• të dëgjojë dhe të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup;• të diskutojë në grup për çështje të caktuara;• të tregojë ngjarje dhe situata nga jeta e tij;

		<ul style="list-style-type: none"> • të marrë role të ndryshme (i moderatorit, i drejtuesit të grupit etj.) që i caktohen në grupe të vogla; • të plotësojë me informacion shtesë planet e grupit duke respektuar mendimet e të tjerëve.
<p>Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste të gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes fëmijët. - Tekste me tematikë të caktuar për moshën, me personazhe të pëlqyer nga nxënësit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • t'u përgjigjet pyetjeve që kanë lidhje me tekste të lexuara ose të dëgjuara nga të tjerët; • të flasë për tekste të ndryshme joletrare që janë në përshtatje me moshën e tij; • të japë mendime rreth përmbajtjeve dhe personazheve të pjesës sipas këndvështrimit të tij.

<p>Të dëgjuarit dhe të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare në të cilat dallohen qartë tipare të llojeve e gjinive të ndryshme letrare. - Pjesë që mund të luhen me role (edhe prozë dhe poezi). - Pjesë nga autorë të letërsisë shqipe dhe botërore 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë llojin letrar të teksteve të ndryshme; • të krahasojë prozën me poezinë. • të përdorë intonacionin sipas llojit letrar për të cilin flet; • të interpretojë me role pjesë të llojeve letrare; • të rendisë ngjarjet sipas rendit kronologjik; • të përforcojë elementet e teknikës së recitimit të mësuara për një të folur të qëllimshëm dhe të këndshëm.
<p>Të folurit duke përdorur njohuritë e gjuhës standarde.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë e nga fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore. - Pjesë letrare ose joletrare me tematikë të caktuar për të pasuruar fjalorin. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shqiptojë fjalën si njësi leksiko-gramatikore; • të përdorë saktë theksin e fjalës; • të përdorë me vend kuptimet e fjalëve sipas situatës që i kërkohet; • t'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve

		<p>që ato marrin në kontekste të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të pasurojë fjalorin.
--	--	--

LINJA: Të lexuarit

Nënlinja	Tematika	Objektivat
Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	<ul style="list-style-type: none"> - Tekste që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme. - Shkrime të llojeve të ndryshme ne media, internet etj. - Informacione për botën që e rrethon dhe më gjerë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë në mënyrë të qëllimshme duke respektuar elemente, si: intonacioni, ritmi, grupet e fjalëve, shenjat e pikësimit; • të lexojë për të kuptuar përmbajtjen e tekstit; • të lexojë për të marrë informacion; • të bëjë pyetje rreth tekstit që lexon, për të kuptuar pjesën; • të dallojë informacionin më të rëndësishëm, që t'i shërbejë si paragraf

		<p>kyç në procesin e të kuptuarit;</p> <ul style="list-style-type: none"> të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme, si: libri, media e shkruar, enciklopedi etj.
Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<ul style="list-style-type: none"> Tekste të llojit letrar e jo letrar që nxisin për të lexuar deri në fund dhe që ngjallin emocione, dëshirë. Pjesë ku nxënësit gjejnë miqtë dhe heronjtë e ëndrrave të tyre nga autorë të letërsisë shqipe dhe botërore. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të lexojë me interes dhe dëshirë tekste të natyrave të ndryshme që i përkasin botës së tij; të mësojë përmendsh pjesë të shkurtra në poezi; të interpretojë në grupe materiale nga pjesë të shkurtra.
Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e tekstit.	<ul style="list-style-type: none"> Tekste që i motivojnë nxënësit të reflektojnë idetë në mënyra të ndryshme: me anë të dramatizimeve, recitimeve, vizatimeve, lojërave, shkrimeve, poezive. Tekste që përshkruajnë mjedise ku veprojnë njerëz, kafshë në kohë të ndryshme. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të ndajë pjesën në fragmente të veçanta, sipas kuptimit të tyre, për të hartuar pikat e planit; të gjejë mesazhin e pjesës së lexuar; të ndajë mendimet e tij me bashkëmoshatarët për çështje që i

		interesojnë.
Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare si: përralla, tregimi, poezi, gjëgjëza, pjesë të shkurtra dramatike. - Pjesë të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare në të cilat dallohen tipare karakteristike të tyre. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të lexojë pjesë të llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare; • të dallojë elemente të tilla, si: paragrafi, dialogu, vargu, strofa; • të dallojë tekstin letrar nga joletrar.
Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë që mund të lexohen, recitohen apo interpretohen me role në mënyrë shprehëse. - Pjesë për t'u lexuar nga mësuesi duke shërbyer si modele interpretuese për nxënësit 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të respektojë intonacionin e duhur gjatë leximeve me zë të lartë të pjesëve në poezi, dramë apo prozë; • të demonstrojë në të lexuar ritmin dhe theksin sipas llojit të tekstit; • të lexojë në heshtje me qëllim kuptimin e tekstit, përcaktimin e personazheve kryesore dhe karakteristikave të tyre.
Të lexuarit në praktikim të njohurive	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesë dhe tekste që pasurojnë të folurit e nxënësve sipas shqipes standarde. 	<p>Nxënësi duhet:</p>

rreth gjuhës standarde shqipe	<ul style="list-style-type: none"> - Materiale ku të përdoren termat <i>përmbajtje, ritregim, motiv, mesazh</i>. 	<ul style="list-style-type: none"> • të shqiptojë saktë të gjithë tingujt e fjalët; • të përdorë saktë theksin te fjalët e njohura; • të dallojë kuptimin e drejtpërdrejtë dhe të figurshëm të fjalëve dhe të shprehjeve të tekstit që lexon; • të dallojë termat <i>përmbajtje, mesazh, ritregim, motiv</i>; • t'i përdorë fjalët e reja sipas kuptimeve që ato marrin në kontekste të ndryshme.
-------------------------------	---	--

LINJA: Të shkruarit

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Të shkruarit me karakter funksional	<ul style="list-style-type: none"> - Shkrime të modeluara të karakterit funksional të tilla si: letra të thjeshta, njoftime, përshkrime të mjedisit ku jeton. - Modele gjysmë të gatshme ku nxënësi duhet të plotësojë fjali ose paragrafë që mungojnë. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shkruajë sipas modeleve të dhëna: letra të thjeshta, njoftime, përshkrime; • të plotësojë modele gjysmë të gatshme të letrave të thjeshta, njoftimeve, përshkrimeve; • të paraqesë me shkrim fakte të thjeshta duke

		<p>ruajtur vërtetësinë e tyre;</p> <ul style="list-style-type: none"> të shkruajë për lexues të ndryshëm.
Të shkruarit për qëllime vetjake dhe më gjerë	<ul style="list-style-type: none"> Modele shkrimesh ku shprehen nevoja vetjake: letër falenderimi, fletë ditari. Modele letrash të thjeshta. Modele shkrimesh ku bëhet fjalë për veprimtari të tilla si: një festë , një veprimtari sportive, një veprimtari edukative në përshtatje me moshën. Materiale me tekste letrare dhe joletrare nga fusha të ndryshme ku nxënësit i kërkohet të bëjë përzgjedhjet e duhura. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të bëjë shkrime të ndryshme për nevoja vetjake (letër falenderimi, një fletë ditari); të shkruajë për të falenderuar. të ndërtojë plane veprimtarish argëtuese, sportive; të mbajë shënime vetjake, të qëllimshme.
Të shkruarit për t'u shprehur me ndjenjë dhe me imagjinatë	<ul style="list-style-type: none"> Modele shkrimesh të ndryshme ku nxënësi gjen të shprehura ndjenja dhe emocione të ndryshme. Materiale të ndryshme që paraqesin situata jetësore të moshës së tyre. Tekste të ndryshme letrare me personazhe të dashur për nxënësit. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshkruajë personazhe nga krijimtaria popullore apo letrare; të përdorë fjalë dhe shprehje të reja; të përshkruajë të afërm, shokë, personazhe dhe kafshë të preferuara.
Njohuri rreth përdorimit të gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> Lloje dhe modele shkrimi me fjali të ndryshme dëftore, pyetëse, dëshirore, thirrmore dhe shenjat 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të

	<p>përkatëse të pikësimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Terminologji gjuhësore, si: <i>titulli, hyrje, paragraf, zhvillim, mbyllje, arsyetim.</i> 	<p>modelit të shkrimit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë fjalët në përshtatje me kontekstin.
--	--	--

LINJA: Njohuri rreth gjuhës

Nënlinjat	Tematika	Objektivat
Sintaksë	<p>Përbërësit e fjalisë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Grupi emëror, grupi foljor. - Kryefjala. - Përcaktori. - Rrethanori. - Kundrinori. <p>Tipet e fjalisë sipas kumtimit</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fjalja dëftore. - Fjalja pyetëse - Fjalja dëshirore. - Fjalja nxitëse. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë grupin emëror dhe grupin foljor në fjali; • të dallojë kryefjalën e shprehur me emër, përemër dhe grup emëror; • të dallojë përcaktorin brenda grupit emëror. • të dallojë rrethanorin si plotës të grupit foljor në pozicione të ndryshme; • të identifikojë kundrinorin; • të përcaktojë llojin e fjalive sipas kumtimit: fjali dëftore, fjali pyetëse, fjali dëshirore, fjali nxitëse.
Morfologji	<ul style="list-style-type: none"> - Emri. - Mbiemri. - Përemri vetor. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë emrat e përgjithshëm dhe të

	<ul style="list-style-type: none"> - Përemri pyetës. - Përemri lidhor. - Mënyrat e foljes. - Kohët e foljes. - Lidhëzat. - Parafjala. 	<p>përveçëm, konkretë dhe abstraktë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë gjininë e emrit; • të përcaktojë numrin e emrit; • të dallojë mbiemrin; • të përcaktojë gjininë e mbiemrit në lidhje me emrin. • të përcaktojë numrin e mbiemrit në lidhje me emrin; • të dallojë përemrin vetor; • të dallojë përemrin pyetës (kush, cili, çfarë, ç); • të përdorë përemrin pyetës në fjali; • të dallojë përemrin lidhor; • të përcaktojë mënyrën e shprehjes së veprimit nga folja; • të dallojë lidhëzat; • të dallojë parafjalët bazë të rasës emërore, kallëzore e rrjedhore;
Drejtshkrim dhe pikësim	<ul style="list-style-type: none"> - Shkronja e madhe. - Apostrofi. - Përdorimi i zanores i dhe y. - Përdorimi i zanores u dhe y. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e

	<ul style="list-style-type: none"> - Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. 	<p>tjera si: emërtimet e rrugëve, institucioneve etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përdorë drejt apostrofin tek përemri pyetës ç’; • të përdorë drejt zanoret i dhe y; • të përdorë drejt zanoret u dhe y; • të ndajë drejt fjalët në fund të rreshtit; • të zbatojë rregullat drejtshkrimore gjatë shkrimit me të kopjuar, diktuar ose në krijime.
Leksikologji dhe fjalëformim	<ul style="list-style-type: none"> - Fjala si njësi më e vogël e kuptimshme e gjuhës. - Sinonimet dhe antonimet. - Përbërësit e fjalës. - Shprehjet frazeologjike. - Fjalori. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë kuptimet e fjalës; • të dallojë fjalët sinonime dhe antonime; • të krijojë çifte sinonimie dhe antonimie; • të gjejë përbërësit e fjalës; • të përdorë shprehjet frazeologjike të thjeshta në situata të ndryshme; • të përdorë fjalorin për qëllime të ndryshme.
Kulturë gjuhësore	<ul style="list-style-type: none"> - Dialektet. - Gjuha standarde. 	<p>Nxënësi duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të dallojë fjalët dialektore të gjuhës shqipe; • të dallojë fjalët e gjuhës standarde nga ato dialektore.